P.nr.4069/2016

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Rrustem Begolli, me zyrtaren ligjore Sanije Troshupa, duke vendosur në çështjen penale kundër të pandehurit M.Z.nga P.1, për shkak të veprës penale Rrezikimi i Trafikut Publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1,të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.II.nr.7064/2016 të datës 19.09.2016, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datën 13.09.2018, në të cilën ishin prezent Prokurori i Shtetit Menduhi Kastrati dhe i pandehuri M.Z., me datë**13.09.2018** në prezencën e palëve mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T GJ Y K I M

I pandehuri:

M.Z.:nga i ati E., e ëma F., e gjinisë I., i lindur me ..., në P.2, tani me vendbanim në Rr.”B. i D. t K.”, nr...., blloku i ri, hyrja – ... në P.1, i martuar, ka të kryer fakultetin, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datë 18.11.2015, rreth orës 14:00, në rrugën “A.K.”, përballë “R.B.”, në P.1, i pandehuri M.Z., ishte duke e drejtuar automjetin e markës “Audi A3”, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., nga pakujdesia, duke menduar lehtë se nuk do të rrezikoj komunikacionin, nuk i është përmbajtur rregullave të komunikacionit, duke rrezikuar jetën e njerzëve dhe duke vepruar në kundërshtim me nenin 126.1 të LPSKRR-së, i cili duke mos e mbajtur distancën e mjaftueshme të sigurisë ndaj automjetit që e kishte para tij dhe duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes, në pamundësi për tu ndalur para çdo pengese, e godet me pjesën e përparme ballore automjetin “Mercedes C220”, ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit ..., në pjesën e pasme të automjetit të tij, të cilin automjet e drejtonte i dëmtuari D.D., i cili nga inercioni i goditjes e godet me pjesën e përparme automjetin “Suzuki Vitara”, ngjyrë hiri, ne targa të regjistrimit ..., në pjesën e pasme të automjetit, të cilin automjet e drejtonte i dëmtuari H.A., i cili nga inercioni i goditjes e godet me pjesën e përparme të automjetit “Peugot XR”, ngjyrë e gjelbërt, me targa të regjistrimit ..., me pjesën e pasme të automjetit, të cilin automjet e drejtonte i dëmtuari S.G., me ç’rast lëndime të lehta trupore, me pasoja të përkohshme për shëndetin pësojnë H.A., Z.A. dhe S.G., dhe shkaktohet aksident komunikacioni me dëmë materiale në automjete;-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikimi i Trafikut Publik, nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 41, 73, 85, 86 të KPRK-së si dhe nenit 248 dhe 365 të KPPRK-së, të pandehurit M.Z.i shqipton:

VËREJTJE GJYQËSORE

Ashtu që të pandehurit **M.Z.**, i bëhët me dije që ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme, që përben vepër penale, dhe se nëse kryen prapë një vepër të tillë, gjykata do të i shqiptoj sanksion me të rëndë penal.

Oblihohet i pandehuri që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedures penale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumën prej **40.88€**, për ekspertizën mjeko-ligjore shumën prej **50€**, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20€**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: **D.D.** dhe **B.D.**, që të dy me vendbanimnë Rr.”R.K.”, L..., nr...., në P.1, me numër të tel. ..., **H.A.** dhe **I.A.**, që të dy me vendbanim në Rr.”S.A.”, nr...., në P.1, me numër të tel. ..., **Z.A.**, me vendbanim në Rr.”S.A.”, nr. ..., në P.1**, S.G.** dhe **D.G.** që të dy me vendbanim në Rr.”Sh.”, në O., me numër të tel. ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civilo-juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka ushtruar aktakuzën PP.II.nr.7064/2016 të datës 19.09.2016, kundër të pandehurit M.Z., për shkak të kryerjes së veprës penale Rrezikimi i Trafikut Publik, nga neni 378 par.6lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale kundër të pandehurit Meriton Zeneli, gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datë 13.09.2018.

Që në fillim të shqyrtimit të dytë, i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale Rrezikimi i Trafikut Publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, ku ka deklaruar se kërkoj një dënim sa më të lehtë, për arsye se e kam gjendjen ekonomike të vështir, jam mbajtës i familjes shtatë (7), anëtarëshe.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehuritProkurori i Shtetit, ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i akuzuari e ka pranuar akuzën në tërësi dhe është i vetëdijshme për rolin dhe rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe i ka propozuar Gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë nga i akuzuari.

Pas deklarimit të të akuzuarit se e pranon fajësinë për veprën penale Rrezikimi i Trafikut Publik nga neni 378 par.6 lidhurme par. 1 të KPRK-së, të cilin pranim të fajësisë e ka bërë pasi që gjykata e ka njoftuar në hollësi për natyrën dhe pasojat e pranimit të tillë, duke qenë i vetëdijshme për pasojat e pranimit të fajësisë, më të cilin pranim fajësie është pajtuar edhe prokurori i shtetit, gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par.1 të KPPRK-së, pikërisht se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, të pranuara nga i akuzuari, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike prandaj, gjykata e aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ngase janë përmbushur kushtet për pranimin e fajësisë nga neni 248 par.1 të KPPRK-së.

Pas pranimit të fajësisë dhe konstatimit të përmbushjes se kushteve të parapara në nenin 248 par. 1, nën – par. 1.1, 1.2, dhe 1.3, të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në nxjerrjen dhe administrimin e provave të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, se i akuzuari e ka kryer veprën penale Rrezikimi i Trafikut Publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nisur nga pranimi i fajësisë, Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Rrezikimi i Trafikut Publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 dhe të KPRK-së, për të cilën i njëjti edhe akuzohet. Andaj, gjykata të njëjtin e

shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat konform nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit e të cilat janë me ndikim me rastin e dënimit, ashtu që ndaj të pandehurit gjykata mori në konsideratë rrethanat lehtësuese se: i pandehuri ishte i sinqertë gjatë shqyrtimit gjyqësor, se e ka pranuar fajësinë, shpreh pendimin e tij, gjendjen e dobët ekonomike, mbajtës i familjes, ndërsa rrethana rënduese nuk gjeti. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, pra, me vërejtje gjyqësore do të arrihet qëllimi i dënimit, se kjo do të ndikoj tek i akuzuariqë në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga çfarë tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.4069/2016, me datë 18.09.2018

Zyrtare Ligjore
Sanije Troshupa

Gjyqtar
Rrustem Begolli

_____ _____

Udhëzim për mjetin juridik:
Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm përmes kësaj Gjykate.